

DEPARTAMENTI



I MARËDHËNIEVE
ME PUBLIKUN

BANKA E SHQIPËRISË

Marrëdhëniet e Bankës së Shqipërisë me të tretët përbëjnë një aspekt shumë të rëndësishëm të aktivitetit të bankës qendrore. Këto marrëdhënie si institucionale, pra bashkëpunimi me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit, ashtu edhe të komunikimit, kryesisht me publikun, e ndihmojnë bankën qendrore për të bërë të njohur aktivitetin e saj si dhe për të siguruar asistencën dhe mbështetjen e nevojshme. Vendosja dhe konsolidimi i marrëdhënieve me të tretët vlerësohet se ka ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e kredibilitetit të bankës qendrore.

Rritja e transparencës së Bankës së Shqipërisë, si një objektiv strategjik dhe parësor, ka si shtyllë kryesore komunikimin me publikun në përgjithësi dhe me median në veçanti. Nëpërmjet funksionit të zëdhënësit të shtypit, Departamenti vendos kontakte të rregullta dhe mbi baza mirëkuptimi me komunitetin e mediave. Vendosja e kontakteve dhe ruajtja e tyre sigurohet nëpërmjet një angazhimi serioz për informim të vazhdueshëm dhe harmonik për të gjitha aspektet që Banka e Shqipërisë i përçon publikut. Departamenti synon të ofrojë për publikun informacione të përditësuara dhe reale për politikën e Bankës së Shqipërisë dhe për rolin e saj, si dhe të nxisë një kuptim më të mirë të veprimtarive kryesore të institucionit duke u përqendruar tek pjesa e publikut që ka kërkesa të shumta për Bankën.

Në zbatim të Strategjisë afatmesme të Bankës së Shqipërisë, ku një frymëmarrje e re iu dha transparencës dhe marrëdhënieve me publikun, më 16 tetor 2000 Sektori i Marrëdhënieve Publike u rikonceptua në Departament të Marrëdhënieve me Publikun.

Rikonceptimi u shpreh në rradhë të parë me krijimin e *njesisë së shtypit*. U rrit ndjeshëm komunikimi me median, u krijuan listat e kontaktit me të dhe u shtua në mënyrë të konsiderueshme sasia e informacionit për publikun e gjerë dhe median. Këto aktivitete, natyrisht u realizuan dhe vazhdojnë të realizohen nëpërmjet bashkëpunimit midis departamenteve që përgjigjen për botimet dhe për teknologjinë, gjë që ka bërë që Banka e Shqipërisë të jetë e pranishme me faqen e saj edhe në internet.

Komunikimi shtrihet edhe në nivel institucionesh nëpërmjet sektorëve të integrim-bashkërendimit dhe sektorit të protokollit. Së pari, Departamenti siguron përqendrimin e marrëdhënieve me institucionet dhe të tretët duke shërbyer si qendër për informim të vazhdueshëm brenda dhe jashtë Bankës, koordinimin e këtyre marrëdhënieve për të shmangur dublimet dhe vendosjen spontane të kontakteve, për të siguruar maksimizimin e përfitimit prej tyre si dhe filtrimin e procesit të marrëdhënieve me të tretët për t'u siguruar që ato janë në përputhje me qëndrimin zyrtar të Bankës së Shqipërisë. Në këtë kuadër, Departamenti koordinon dhe përgatit gjithë procedurat e nevojshme për të siguruar marrëdhënie të vazhdueshme me banka qendrore, me banka tregtare, me institucione financiare ndërkombëtare, me organizma rajonale etj., si dhe siguron respektimin e detyrimeve që rrjedhin prej tyre. Nëpërmjet këtyre marrëdhënieve, Departamenti siguron zgjerimin e hapësirave të Bankës së Shqipërisë për të bashkëpunuar me të tretët dhe për të përfituar asistencë prej tyre. Po në këtë kuadër, Departamenti ofron dhe shërbimin e protokollit për të gjitha takimet dhe vizitat që organizohen në Bankën e Shqipërisë. Nëse duhet që të kontaktoni Bankën e Shqipërisë apo të vizitoni atë, ky Departament do t'ju ndihmojë për ta realizuar kërkesën tuaj.

Si detyrë të veçantë Departamenti ka edhe administrimin e marrëdhënieve me bankat korrespondente gjatë fazave të çeljes, negociimit sipas rastit të termave e kushteve të mbajtjes së llogarive me korrespondentët, si dhe mbylljes së llogarive në bashkëpunim me struktura përkatëse të shtetit shqiptar.

Një objektiv i rëndësishëm, që klasifikohet si afatgjatë, është edhe përpjekja për të rritur shkallën e integritit në kuadër të procesit të asociim-stabilizimit me Bashkimin Europian. Për arritjen e tij Banka e Shqipërisë ka zgjedhur si model Bankën Qendrore Europiane. Departamentit i është ngarkuar roli i koordinatorit në procesin integrues si dhe i "ambasadorit" të Bankës së Shqipërisë për Europën.